

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Auditim
zgjidhjet**

P6

Data 01/10/2022

Detyra 1

Ju jeni një senior i auditimit në firmën e auditimit Logo dhe po planifikoni auditimin e Blini ShA për vitin që përfundon më 31 Mars 2022. Kompania është një prodhues i pajisjeve muzikore dhe menaxheri juaj i auditimit ka pasur tashmë një takim planifikimi me drejtorin financiar. Të hyrat e parashikuara janë 68.6 milion Euri dhe fitimi para tatimit është 4.2 milion Euri. Ajo ju ka dhënë shënimet e mëposhtme të takimit:

Shënimet e takimit planifikues:

Stoqet vlerësohen me vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kostoja përbëhet nga çmimi i blerjes së lëndëve të para dhe kostot e konvertimit, duke përfshirë punën, prodhimin dhe shpenzimet e përgjithshme. Stoqet mbahen në tre depo në të gjithë vendin. Kompania planifikon të kryejë numërimin e plotë të stoqeve në depo në datat 2, 3 dhe 4 Prill dhe do të bëhet çdo rregullim i nevojshëm për të pasqyruar lëvizjet e stoqeve pas fundit të vitit. Ekipi i auditimit të brendshëm do të ndjekë numërimin.

Gjatë vitit, Blini ShA pagoi 1.1 milion Euro për të blerë një patentë që i lejon kompanisë të drejtën ekskluzive për tre vjet për të personalizuar pajisjet e muzikës për të fituar një avantazh konkurrues në industrinë e tyre. Shuma pre 1.1 milion Euro është paraqitur si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave të vitit aktual. Për të financuar këtë blerje, Blini ShA mbledhi 1.2 milion Euro nëpërmjet emetimit të aksioneve me çmim premium.

Në nëntor 2021, u zbulua se një mashtrim i konsiderueshëm ishte kryer nga katër anëtarë të departamentit të librit të shitjeve, të cilët kishin pasur marrëveshje të fshehtë të bashkëpunimit. Ata kishin vjedhur fondet nga pranimiti i parave të klientëve me shumicë dhe më pas për ta mbuluar këtë, ata kishin ndarë faturat e mëvonshme të klientëve kundrejt të arkëtueshmeve më të vjetra. Të gjithë këta punonjës u raportuan në polici dhe më pas u pushuan nga puna. Si rezultat i vendeve të lira të punës në departamentin e librit të shitjeve, Blini ShA vendosi të transferojë përpunimin e librit të saj të shitjeve tek një organizatë e jashtme shërbimi . Kjo organizatë shërbimi trajton të gjithë elementët e ciklit të librit të shitjeve, duke përfshirë faturimin e shitjeve dhe ndjekjen e bilanceve të arkëtueshme dhe i dërgon raporte mujore Blini ShA duke detajuar shitjet dhe shumatat e arkëtueshme. Blini ka mirëmbajtur librin e vet të shitjeve deri më 31 janar 2022, në të cilën pikë të dhënat u transferuan në organizatën e shërbimit . Në dhjetor 2021, kontabilisti financiar i Blini u shkarkua. Ai ka qenë i punësuar në kompani për nëntë vjet dhe ka kërcënuar se do ta padisë kompaninë për largim të padrejtë nga puna. Si rezultat i këtij shkarkimi dhe deri sa zëvendësimi i tij të fillojë punën në prill, përgjegjësitë e kontabilistit financiar u janë ndarë në mënyrë adekuate anëtarëve të tjerë të departamentit të financave. Megjithatë, për këtë periudhë nuk janë kryer rakordime të pasqyrave të furnitorëve apo rakordime të llogarisë së kontrollit të librit të blerjeve.

Në janar 2021, një saldo e arkëtueshmeve prej 0.9 milion Euro u fshi nga Blini ShA pasi u konsiderua i parikuperueshëm pasi klienti kishte deklaruar veten të falimentuar. Në shkurt 2022, likuiduesit që trajtonin falimentimin e kompanisë njoftuan publikisht se kishte gjasa që shumica e kreditorëve të saj të merrnin një pagesë prej 40% të saldosit të borxhit. Si rezultat, Blini ShA ka përfshirë një pasuri qarkulluese prej 360,000 Euri në pasqyrën e pozicionit financiar dhe të ardhurave të tjera në pasqyrën e të ardhurave.

Kërkohet:

- (a) Përshkruani përgjegjësitë e firmës së auditimit në lidhje me parandalimin dhe zbulimin e mashtrimit dhe gabimit. (4 pikë)
- (b) Përshkruani TETË rreziqe të auditimit dhe shpjegoni përgjigjen e auditorit ndaj secilit rrezik në planifikimin e auditimit të Blini.

Shënim: Përgatitni përgjigjen tuaj duke përdorur respektivisht dy kolona të titulluara Rreziku i auditimit dhe përgjigja e auditorit. (16 pikë)

[Gjithsej: 20 pikë]

Zgjidhja

1 (a) Përgjegjësia e mashtrimit

Logo duhet të kryejë një auditim në përputhje me SNA 240 *Përgjegjësitë e Auditorit në lidhje me Mashtrimin në një Auditim të Pasqyrave Financiare* dhe është përgjegjës për të përfutur një siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare të marra në tërësi janë pa anomali materiale, qoftë të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Për të përmbushur këtë përgjegjësi, Logo-s i kërkohet të identifikojë dhe vlerësojë rreziqet e anomalive materiale të pasqyrave financiare për shkak të mashtrimit.

Ata duhet të marrin evidenca të mjaftueshme he të përshtatshme të auditimit në lidhje me rreziqet e vlerësuara të anomalive materiale për shkak të mashtrimit përmes hartimit dhe zbatimit të përgjigjeve të duhura. Për më tepër, Logo duhet t'i përgjigjet në mënyrë të përshtatshme mashtrimit ose mashtrimit të dyshuar të identifikuar gjatë auditimit.

Kur përfuton siguri të arsyeshme, Logo është përgjegjëse për ruajtjen e skepticizmit profesional gjatë gjithë auditimit, duke marrë parasysh potencialin për tejkalim të kontrolleve nga menaxhmenti dhe duke njohur faktin se procedurat e auditimit që janë efektive në zbulimin e gabimeve mund të mos jenë efektive në zbulimin e mashtrimit.

Për të siguruar që i gjithë ekipi i angazhimit është i vetëdijshëm për rreziqet dhe përgjegjësitë për mashtrimin dhe gabimin, ISA 240 kërkon që të zhvillohet një diskutim brenda ekipit. Për anëtarët që nuk janë të pranishëm në takim, partneri i angazhimit të auditimit të Blinit duhet të përcaktojë se cilat çështje duhet t'u komunikohen atyre.

b)

Rreziku i auditimit	Përgjigja e auditorit
Në nëntor 2021, u zbulua se një mashtrim i konsiderueshëm ishte kryer nga katër anëtarë të departamentit të librit të shitjeve. Ekziston rreziku që ndikimi i plotë i mashtrimit të mos jetë përcaktuar dhe mund të ketë transaksione tjera mashtruese të fshehura në pasqyrën e të ardhurave. Nëse këto nuk janë zbuluar, pasqyrat financiare mund të përmbajnë anomali.	Diskutoni me drejtorin financiar se cilat procedura kanë adoptuar për të identifikuar dhe për të përcaktuar plotësisht ndikimin e mashtrimit. Përveç kësaj, diskutoni me drejtorin financiar se çfarë kontrollesh janë vendosur për të identifikuar ndonjë mashtrim të ngjashëm. Rishikoni listën e të arkëtueshmeve për të identifikuar çdo postim të pazakontë në bilancet individuale të arkëtueshme pasi kjo mund të jetë dëshmi e mëtejshme e transaksioneve mashtruese.
Përveç kësaj, saldot individuale të arkëtueshme mund të jenë të nënvlerësuara/mbivlerësuara pasi të hyrat e klientëve janë shpërndar gabimisht në saldo të tjera të arkëtueshme.	Përveç kësaj, ekipi duhet të ruajë skepticizmin e tyre profesional dhe të jetë vigjilent ndaj rrezikut të mashtrimeve dhe gabimeve të mëtejshme.
Gjatë vitit Blini kishte kontraktuar funksionin e librit të shitjes te një organizate shërbimi të jashtme. Mund të paraqitet një rrezik moszbulimi nëse vihen në pyetje dëshmitë e mjaftueshme dhe të përshtatshme te kompania Blini për të konfirmuar plotësinë dhe saktësinë e kontrolleve mbi ciklin e shitjeve dhe të arkëtueshmeve dhe saldot në fund të vitit.	Diskutoni me menaxhmentin shtrirjen e të dhënave të mbajtura në Blini për periudhën që nga shkurti 2022 dhe çdo monitorim të kontrolleve të ndërmarra nga menaxhmenti mbi shitjet dhe të arkëtueshmet. Duhet t'i kushtohet vëmendje kontaktit me auditorin e organizatës për shërbime për të konfirmuar nivelin e kontrolleve të vendosura.

<p>Përpunimi i librit të shitjeve i transferohet organizatës së shërbimit nga 1 shkurt 2022. Nëse ka ndodhur ndonjë gabim gjatë procesit të transferimit, këto mund të rezultojnë në nën/mbivlerësimin e shitjeve dhe të arkëtueshmeve.</p>	<p>Diskutoni me menaxhmentin procesin e transferimit të ndërmarrë dhe çdo kontroll të vendosur për të siguruar plotësinë dhe saktësinë e të dhënave.</p> <p>Aty ku është e mundur, ndërmerrni teste të kontrolleve për të konfirmuar efektivitetin e kontrolleve të transferimit. Përveç kësaj, kryeni testime thelbësore për transferimin e informacionit nga sistemi i vjetër në atë të ri.</p>
<p>Në dhjetor 2021, kontabilisti financiar i Blinit u shkarkua dhe kërcënon të padisë kompaninë për shkarkim të padrejtë. Nëse ka mundësi që Blini të bëjë një pagesë te kontabilisti financiar, kërkohet një provision për shkarkim të padrejtë nga puna. Nëse pagesa është e mundur dhe jo e mundshme, do të ishte e nevojshme një shpalosje e detyrimit kontingjent. Nëse Blini nuk e ka bërë këtë, ekziston rreziku mbi plotësinë e çdo provizionit ose detyrimi kontingjent.</p>	<p>Ekipi i auditimit duhet të kërkojë konfirmim nga avokatët e kompanisë për ekzistencën dhe gjasat e suksesit të çdo pretendimi nga ish-kontabilisti financiar.</p>
<p>Asnjë kartelë e furnitorit apo rakordimi i llogarisë së kontrollit të librit të blerjeve nuk është kryer në periudhën nga dhjetori 2021 deri në fund të vitit.</p> <p>Ky është një kontroll kyç i cili është duke u anashkaluar dhe si i tillë ka një rrezik në rritje të anomalive brenda të pagueshmeve tregtare dhe saldo e të pagueshmeve në fund të vitit mund të jetë nën ose i mbivlerësuar.</p>	<p>Ekipi i auditimit duhet të rrisë testimin e tyre mbi të pagueshmet tregtare në fund të vitit, duke përfshirë kryerjen e rakordimeve të kartelave të furnitorëve, me fokus të veçantë në plotësinë e të pagueshmeve tregtare.</p> <p>Të kërkohet nga menaxhmenti të përgatisë një rakordim të llogarisë së kontrollit të librit të blerjeve në fund të vitit. Ekipi i auditimit duhet të ndërmarrë një rishikim të detajuar të këtij rakordimi me fokus në çdo zë të pazakontë rakordues.</p>
<p>Një pasuri qarkulluese prej €360,000 është përfshirë në pasqyrën e të ardhurave dhe në pasuri. Ajo përfaqëson një pagesë të parashikuar nga likuiduesit që trajtojnë falimentimin e një klienti që i detyrohej Blinit 0.9 milion Euro. Shuma prej 0.9 milion Euro u fshi nga pasqyrat e vitit të kaluar.</p> <p>Megjithatë, kompania nuk ka marrë një njoftim zyrtar nga likuiduesit që konfirmon pagesën dhe për rrjedhojë kjo do të përfaqësonte një pasuri të mundshme kontingjente.</p> <p>Për të qenë në përputhje me SNK 37 <i>Provizionet, Detyrimet Kontingjente dhe Pasuritë Kontingjente</i>, kjo nuk duhet të njihet derisa inksimi të jetë praktikisht i sigurt. Pa asnjë përgjigje të fortë deri më sot, përfshirja e kësaj shume mbivlerëson fitimin dhe pasuritë qarkulluese.</p>	<p>Diskutoni me menaxhmentin nëse është marrë ndonjë njoftim për pagesë nga likuiduesit dhe rishikoni korrespondencën përkatëse. Nëse praktikisht është i sigurt, trajtimi i miratuar është i saktë. Nëse pagesa është marrë, rakordoni pagesën me librin e parave të gatshme pas fundit të vitit.</p> <p>Nëse arkëtimi nuk është praktikisht i sigurt, menaxhmentit duhet t'i kërkohet ta heqë atë nga fitimi dhe të arkëtueshmet. Nëse inkasimi është i mundshëm, auditori duhet t'i kërkojë menaxhmentit të përfshijë një shpalosjeje të pasurisë kontingjente.</p>

Detyra 2

Firma juaj e auditimit, CD & Partnerët sapo ka marrë një klient të ri, Lala ShPK një klub shumë i suksesshëm shëndetësor që operon me anëtarësim ashtu edhe sistemin e pagesës sipas përdorimit. Lala, e cila filloi biznesin në 2015, është përballur me konkurrencë për dy vitet e fundit nga një klub shëndetësor mbarëkombëtar, Gyms ShPK, i cili operon një politikë vetëm për anëtarët. Ju sapo jeni informuar se firma juaj ka marrë një ftesë për tender për auditimin e kompanisë që zotëron Gyms ShPK. Drejtori Menaxhues i Lala, Meritoni, është një mik i vjetër i shkollës i menaxherit tuaj të auditimit dhe kjo ndodhi nëpërmjet kësaj lidhje që firma juaj ishte në gjendje të tenderonte për auditimin e saj. Ju jeni caktuar si senior i auditimit për Lala. Në një vizitë të fundit në zyrën tuaj, Meritoni deklaroi se do të dëshironte t'i jepte një ofertë të gjithë stafit të CD & Partnerët përmes së cilës ata do të kishin të drejtë për një tarifë të veçantë anëtarësimi, e cila është 50% e tarifave standarde të anëtarësimit dhe më pas i jep të drejtë anëtarit për 75% zbritje në klasa speciale të klubit. Ai gjithashtu propozoi që ju të bëheni pjesë e bordit të drejtorëve në Lala si drejtor joekzekutiv. Për më tepër, ai propozoi që firma juaj të konfirmonte, si pjesë e auditimit, shifrat e një pretendimi sigurimi që do të dorëzohej në lidhje me dëmet e shkaktuara nga dëmtimi i një tubi uji. Tubi shpërtheu gjatë një moti të ftohtë në zonën kryesore të palestrës pak para fundit të vitit.

Kërkohet:

(a) Në kontekstin e skenarit të mësipërm :

(i) Vlerësoni kërcënimet etike (reale ose të perceptuara) të cilat mund të ndikojnë në pavarësinë e firmës tuaj të auditimit lidhur me auditimin e Lala ; (8 pikë)

(ii) Për çdo kërcënim rekomandoni se si mund të eliminohet ose zbutet në një nivel të kënaqshëm. (8 pikë)

(b) Diskutoni përfitimet e një komiteti auditimi për një kompani. (4 pikë)

[Gjithsej: 20 pikë]

Zgjidhja

a)

Kërcënim (i)	Masat mbrojtëse (ii)
Tarifat e anëtarësimit të stafit në Lala - kërcënim i interesit vetjak Një përfitim i tillë mund të shkaktojë një kërcënim të interesit vetjak për auditimin, sepse marrësit mund të mos duan të humbasin përfitimin e tyre, dhe për këtë arsye të jenë të njëanshëm në punën e tyre të auditimit ose të mos kërkojnë rregullime aty ku ka çështjet materiale në pasqyrat financiare.	Audituesit nuk lejohen të pranojnë përfitime të tilla, përveç nëse vlera e tyre është e parëndësishme. Në këtë rast, vlera e një anëtarësie të reduktuar në një klub nuk ka gjasa të jetë e parëndësishme për anëtarët e stafit të auditimit dhe për këtë arsye CD&Partneret duhet ta refuzojë këtë ofertë.
Partneri i ftuar për t'u bërë pjesë e bordit - kërcënim njohjeje Nëse partnerido të bëhej anëtar në bordin e drejtorëve, ekziston rreziku që partneri të humbasë objektivitetin e auditimit pasi mund të fillojë të identifikohet shumë ngushtë me kompaninë dhe drejtorët e tjerë të saj. Ekziston gjithashtu rreziku që partneri i auditimit të fillojë të marrë përgjegjësinë e menaxhimit në Lala.	Audituesit janë të ndaluar nga Kodi i Etikës të veprojnë si drejtor për klientët e tyre. Kjo duhet t'i shpjegohet Drejtorit Menaxhues dhe ta refuzojë me mirësjellje ftesën.
Pretendimi i sigurimit - kërcënim i avokimit Firmat e auditimit duhet gjithmonë	Partnerët duhet të zbulojnë më shumë për madhësinë dhe natyrën e këtij angazhimi për

Kërcënimi (i)	Masat mbrojtëse (ii)
të sigurojnë që pranimi i shërbimeve të tjera të mos ndikojë në objektivitetin e auditimit, qoftë për shkak të shumës së tarifave në lidhje me shërbimin ose si rezultat i vetë natyrës së shërbimit.	të përcaktuar nëse do të ndikojë në pavarësinë. Në veçanti, ata duhet të përcaktojnë nëse një angazhim i tillë do ta vendoste firmën në pozicionin e mbrojtjes së pozicionit të Lalës në kompaninë e sigurimeve, pasi kjo gjë shkakton një pengesë të pakapërcyeshme për pavarësinë. Ata duhet gjithashtu të monitorojnë nivelin e të ardhurave nga tarifatat që do të fitonte CD&Partneret nga e gjithë puna e kryer për Lala për t'u siguruar që ajo të mos shkaktojë kërcënim për interesin vetjak.
Konflikti i interesit CD&Partneret është ftuar në tender për një auditim që do të përfshijë konkurrentin kryesor të Lalës, Gyms ShPK. Mund të jetë e përshtatshme që firmat e auditimit të auditojnë konkurrentët, por klientët e përfshirë mund të mendojnë se ekziston një kërcënim për konfidencialitetin e klientit dhe mund të preferojnë të kërkojnë auditorë të tjerë në një situatë të tillë	CD&Partneret duhet t'i shpalosin Lalës se janë në proces tenderimi për auditimin e një konkurrenti. Nëse Lala ose Gyms janë të pakënaqur me këtë situatë, atëherë CD&Partneret do të duhet të vendosë se cilin auditim duan të sigurojnë. Nëse CD&Partneret kryejnë të dy auditimet, ata duhet të sigurojnë që të përdorin partnerë dhe ekipe të veçanta auditimi dhe të krijojnë "mure kineze" për të mirëmbajtur konfidencialitetin

Përfitimet e një komiteti auditimi

- (i) Një anëtar i komitetit të auditimit duhet të ketë përvojë financiare përkatëse dhe kështu kjo duhet të rrisë besueshmërinë dhe objektivitetin e raporteve financiare të kompanisë.
- (ii) Të kesh drejtorë të veçantë jo-ekzekutivë në komitetin e auditimit do t'u çlirojë drejtorëve ekzekutivë kohën për t'u fokusuar në udhëheqjen e biznesit.
- (iii) Komiteti i auditimit ofron një organ të paanshëm që audituesit të konsultohen me drejtorët ekzekutivë kur ka çështje gjykimi të cilat janë të pazgjidhura.
- (iv) Komiteti i auditimit do të monitorojë objektivitetin dhe pavarësinë e auditorëve të jashtëm
- (v) Komiteti i auditimit është një pikë referimi për funksionin e auditimit të brendshëm pasi ai do të monitorojë fushëveprimin e departamentit të auditimit të brendshëm dhe do të takohet rregullisht me drejtuesin e auditimit të brendshëm për të siguruar që ata janë në gjendje të punojnë në mënyrë efektive.

Detyra 3

Ju jeni senior i auditimit të Mik-IT e cila ka një fund viti 31 dhjetor 2021. Mik-IT shkruan dhe zhvillon softuer kompjuterik për shitje te prodhuesit ndërkombëtarë të kompjuterave. Fitimi para tatimit për vitin arriti në €490,000 me një bazë neto të pasurisë prej €3.45 milion. Çështjet e mëposhtme janë identifikuar si pjesë e punës së auditimit në fund të vitit.

Çështja e auditimit 1

Një pretendim thelbësor është paraqitur kundër Mik-IT që rrjedh nga softueri i shitur një klienti në janar 2021. Klienti po pretendon se softueri i ofruar ishte me të meta dhe rezultoi në një tërheqje të disa modeleve kompjuterike. Nuk është bërë asnjë parashikim për kompensimin e pagueshëm nga Mik-IT pasi nuk është e mundur të vlerësohen me saktësi të arsyeshme shumat, nëse ka, të cilat mund të bëhen të pagueshme. Partneri i auditimit është pajtuar me këtë vlerësim dhe është i kënaqur që kompensimi që mund të bëhet i pagueshëm nuk mund të vlerësohet me saktësi të arsyeshme në këtë pikë. Drejtorët e Mik-IT kanë përfshirë një shënim që shpjegon këtë çështje në pasqyrat financiare.

Çështja e auditimit 2

Një provizion ristrukturimi ishte njohur në pasqyrat financiare të Mik-IT për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020, në lidhje me një riorganizim për të cilin Mik-IT ishte zotuar më 31 dhjetor 2020. Provizioni u regjistrua me një kosto totale prej €200,000 (duke reflektuar kostot totale që do të ndodhin gjatë dy viteve deri në dhjetor 2022). Kostot e ristrukturimit të bëra në vitin aktual arritën në 56,000€ që ishte në përputhje me provizionin fillestar të vlerësuar. Kjo shumë u regjistrua si më poshtë:

- Debi: shpenzimet operative 56,000 €
- Kredi: Banka 56,000€

Miratimi i pasqyrave financiare

Menaxheri i auditimit ju ka kërkuar që të kryeni procedurat e përfundimit të auditimit në lidhje me Mik-IT pasi pasqyrat financiare duhet të miratohen nga drejtorët e Mik-IT brenda dy javësh [në pritje të zgjidhjes së Çështjeve të Auditimit (1) dhe (2) të përmendura më sipër]. Megjithatë, partneri i auditimit përgjegjës për nënshkrimin e raportit të auditimit do të jetë në pushim vjetor gjatë kësaj periudhe.

Kërkohe:

- (a) Vlerësoni konsideratat e auditimit që rrjedhin nga pretendimi i bërë kundër Mik-IT (Çështja e Auditimit 1 më lart), duke përfshirë çdo implikim të mundshëm në raportin e auditimit. (8 pikë)
- (b) Vetëm në lidhje me Çështjen 2 të Auditimit:
 - (i) Diskutoni ndikimin në raportin e auditimit; dhe
 - (ii) Përshkruani pikat që duhet të përfshihen në një raport auditimi të kualifikuar. (8 pikë)
- (c) Përmbledhni implikimet për auditimin nëse partneri i auditimit është në pushim vjetor kur drejtorët e Mik-IT miratojnë pasqyrat financiare. (4 pikë)

[Gjithsej: 20 pikë]

Zgjidhja

Pretendimi i bërë kundër Mik-IT

- Konsideratat e auditimit

- Mik-IT ka pranuar një pretendim për mallra me defekt nga një klient që po kërkon dëmshpërblim. Për shkak të natyrës së pretendimit, nuk është e mundur të vlerësohen me saktësi të arsyeshme shumat, nëse ka, të cilat mund të bëhen të pagueshme dhe rrjedhimisht nuk është bërë asnjë provizion në pasqyrat financiare.

- Duke qenë se rezultati i veprimit do të varet nga zhvillimet e ardhshme, kjo përbën një pasiguri e cila përkufizohet sipas SNA 700 (i rishikuar) si një çështje, rezultati i së cilës varet nga veprimet ose ngjarjet e ardhshme që nuk janë nën kontrollin e drejtpërdrejtë të entitetit, por që mund të ndikojnë në pasqyrat financiare.

- Për të përcaktuar nëse pasiguria e lartpërmendur përbën një pasiguri të rëndësishme, çështjet e mëposhtme duhet të trajtohen:

- rreziku që vlerësimi i përfshirë në pasqyrat financiare mund të jetë subjekt i ndryshimit;

- gamën e rezultateve të mundshme; dhe

- pasojat e këtyre rezultateve në pamjen e paraqitur në pasqyrat financiare.

- Nga informacioni i dhënë duket se ka një gamë të gjerë rezultatesh të mundshme dhe pasoja e mundshme në pamjen e paraqitur nga pasqyrat financiare, duke pasur parasysh rëndësinë e shkëlqes së kontratës, do të duket të jetë e rëndësishme. Mbi këtë bazë, veprimi juridik do të përbënte një pasiguri të konsiderueshme. Trajtimi kontabël i adoptuar për pasigurinë është në përputhje me SNK 37 i cili kërkon që një detyrim kontingjent të shpaloet në rastet kur nuk mund të bëhet një vlerësim i besueshëm i një provizionit të mundshëm. Prandaj, ne nuk do të pajtoheshim me trajtimin e miratuar nga Mik-IT.

- ISA 700 (i rishikuar) thekson se raporti i auditimit duhet të modifikohet duke shtuar një paragraf nëse ka një pasiguri domethënëse (përveç problemit të vijimësisë), zgjidhja e së cilës varet nga ngjarjet e ardhshme dhe që mund të ndikojë në pasqyrat financiare si është rasti në Mik-IT

- Një paragrafi i theksimit të çështjes që përshkruan çështjen që ndikon në pasqyrat financiare duhet të përfshihet në raportin e auditimit. Shtimi i një paragrafi të tillë të theksimit të çështjes nuk ndikon në opinionin e auditorit

- Paragrafi i theksimit të çështjes përshkruan çështjen që shkakton pasiguri domethënëse dhe efektet e saj të mundshme në pasqyrat financiare, duke përfshirë (aty ku është e mundur) kuantifikimin. Kur nuk është e mundur të përcaktohet sasia e efekteve të mundshme të zgjidhjes së pasigurisë, siç është rasti në Mik-IT, një deklaratë për këtë duhet të përfshihet në raportin e auditimit. Mund t'i referohemi shënimeve në pasqyrat financiare, por një referencë e tillë nuk është një zëvendësim për përshkrimin e mjaftueshëm të pasigurisë së rëndësishme në mënyrë që një lexues të mund të vlerësojë pikat kryesore në fjalë dhe implikimet e tyre

- Nëse pas rishikimit shtesë konstatohet se vlerësimi për rezultatin e kësaj pasigurie domethënëse është keqdeklaruar materialisht ose shpalosja në lidhje me të është e pamjaftueshme, duhet të jepet një opinion i kualifikuar.

(b) Implikimet për raportin e auditimit

Provizioni i ristrukturimit është llogaritur gabimisht në vitin aktual. Shuma e provizionit të ndodhur gjatë vitit prej 56,000€ duhet të ishte vendosur kundrejt provizionit që ishte krijuar në vitin paraprak dhe jo të mbingarkohej në pasqyrën e të ardhurave në përputhje me SNK 37. Korrigjimi i llogarive që kërkohet është:

– D: Provisionsi 56,000 €

– K: Pasqyra e të ardhurave (Kostot Operative) 56,000 €

Si i tillë, fitimi nënvlerësohet me këtë shumë që barazohet me 11% të fitimit para tatimit. Kjo shumë është materiale por jo aq materiale sa t'i bëjë pasqyrat financiare seriozisht mashtruese. Si i tillë, raporti i auditimit duhet të modifikohet në bazë të një mosmarrëveshjeje në trajtimin kontabël, dmth përveç kualifikimit.

Raporti i auditimit do të ishte normal deri në paragrafin e opinionit

Opinionit

Në pasqyrat financiare janë bërë provizione për një provizion ristrukturimi që do të përdoret gjatë viteve 2021 dhe 2022. Shumat e bëra në lidhje me këtë provizion në vitin aktual janë ngarkuar në pasqyrën e të ardhurave, e cila, sipas mendimit tonë, nuk është në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit. Në përputhje me SNK 37, shumat e krijuara në lidhje me një provizion ristrukturimi duhet të vendosen kundrejt provizionit fillestar dhe rrjedhimisht fitimi para tatimit nënvlerësohet me 56,000€ dhe provizioni mbivlerësohet me të njëjtën shumë.

(c) Nëse partneri vendos të nënshkruajë pasi drejtorët të kenë miratuar pasqyrat financiare, auditori duhet të sigurojë që drejtorët do të kishin miratuar pasqyrat financiare në atë datë të mëvonshme (për shembull, duke marrë konfirmimin nga anëtarët individualë të caktuar të bordit të cilit i është deleguar autoriteti për këtë qëllim); dhe procedurat për rishikimin e ngjarjeve të mëvonshme mbulojnë periudhën deri në atë datë. Përndryshe, partneri mund të kërkojë nga klienti që të vonojë miratimin e pasqyrave financiare derisa raporti i auditimit dhe miratimi i pasqyrave financiare të mund të datohen me të njëjtën datë.

Detyra 4

Ju jeni senior i auditimit të Net ShPK dhe jeni gati të filloni auditimin vjetor të kompanisë. Net është një shpërndarës me shumicë i djathrave të Kosovës. Rrjeti i shpërndarjes i Net aktualisht përbëhet nga katër vende; Kosova, Shqipëria, Mali i Zi dhe Maqedonia. Për të siguruar vazhdimësinë e furnizimit, kompania ka një depo shpërndarjeje në çdo vend. Zyra qendrore e saj ndodhet në Kosovë, ku administrimi, blerja dhe funksionet e kontabilitetit trajtohen për të katër tregjet. Duke pasur parasysh shtrirjen gjeografike të tregjeve të saj, kontrollet e brendshme të forta janë të një rëndësie të madhe për Net ShPK. Gjatë auditimit ju do të kryeni një ekzaminim të detajuar të Net ShpK dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollet e brendshme të kompanisë.

Kërkohet:

- (a) Përshkruani se çfarë nënkuptohet me termin 'mjedis i kontrollit të brendshëm' dhe vlerësoni TRE faktorë kryesorë që do të reflektohen në mjedisin e kontrollit të një kompanie si Net ShPK. (7 pikë)
- (b) Diskutoni pse është e rëndësishme që auditori të njihet me kompaninë dhe mjedisin e saj, duke përfshirë kontrollet e brendshme të kompanisë. (5 pikë)
- (c) Këshilloni pse një auditor do të dëshirojë të përcaktojë nëse kontrollet e brendshme të një kompanie janë efektive dhe përshkruani fazat e përfshira në rishikimin e kontrolleve. (6 pikë)
- (d) Për çdo dy faza të përmendura në përgjigjen tuaj për (c) më sipër, jepni NJË shembull specifik të një aktiviteti të lidhur me atë fazë. (2 pikë)

[Gjithsej: 20 pikë]

Zgjidhja

(a) Mjedisin e kontrollit të një kompanie i referohet mjedisit të krijuar nga drejtorët dhe ekzekutivët e kompanisë, nëpërmjet qëndrimit, ndërjegjësimit dhe veprimeve të tyre, në lidhje me kontrollet e brendshme të kompanisë dhe rëndësinë e tyre në kompani.

Faktorët kryesorë që do të reflektohen në mjedisin e kontrollit të Net janë:

- mënyra në të cilën parimet e integritetit dhe vlerat etike komunikohen dhe zbatohen brenda kompanisë;
- konsiderata nga menaxhmenti i niveleve të kompetencave të kërkuara për punë të veçanta dhe se si këto përkthehen në aftësi dhe njohuri të nevojshme;
- qëndrimet e bordit të drejtorëve - në veçanti, pavarësia e drejtorëve nga ekzekutivët, përvoja dhe statusi i tyre, shkalla e përfshirjes së tyre në kompani, informacioni që ata marrin, shqyrtimi i tyre i aktiviteteve të kompanisë, shkalla në të cilën ata rrisin dhe ndjekja e pyetjeve të vështira me drejtorët ekzekutiv dhe ndërveprimin e tyre me auditorët e brendshëm dhe të jashtëm të entitetit;
- filozofinë dhe stilin e funksionimit të drejtorëve ekzekutiv të lartë, në veçanti, qasjen e tyre për marrjen dhe menaxhimin e rreziqeve të biznesit, dhe qëndrimet ndaj funksionit të kontabilitetit, përpunimit të informacionit dhe raportimit financiar;
- strukturën organizative brenda së cilës kompania planifikon dhe kërkon të arrijë, kontrollojë dhe rishikojë objektivat e saj;
- si caktohen autoriteti dhe përgjegjësia për aktivitetet operative, dhe si vendosen marrëdhëniet e raportimit dhe hierarkitë e autorizimit; dhe
- politikat dhe praktikën e burimeve njerëzore që kanë të bëjnë, për shembull, me rekrutimin, orientimin, trajnimin, vlerësimin, këshillimin, promovimin, kompensimin dhe veprimet korigjuese. (2 pikë për faktor/maksimumi 6 pikë)

(b) SNA 315 shpjegon: Të kuptuarit e entitetit dhe mjedisit të tij, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të entitetit.....është një veprim i vazhdueshëm, proces dinamik i mbledhjes,

përditësimit dhe analizimit të informacionit gjatë gjithë auditimit. Njohja me entitetin krijon një kornizë referimi brenda së cilës auditori planifikon auditimin dhe ushtron gjykimin profesional gjatë gjithë auditimit, për shembull:

- Vlerësimi i rreziqeve të anomalive materiale të pasqyrave financiare;
- Përcaktimi i materialitetit dhe vlerësimi nëse gjykimi për materialitetin mbetet i përshtatshëm ndërsa auditimi përparon
- Duke marrë parasysh përshtatshmërinë e përzgjedhjes dhe aplikimit të politikave kontabël, dhe përshtatshmërinë e shpalosjeve të pasqyrave financiare
- Identifikimi i fushave ku mund të jenë të nevojshme konsiderata të veçanta të auditimit, për shembull, transaksionet e palëve të lidhura, përshtatshmëria e përdorimit të supozimit të vazhdimësisë nga menaxhmenti, ose marrja në konsideratë e qëllimit të transaksioneve të biznesit;
- Zhvillimi i pritjeve për përdorim gjatë kryerjes së procedurave analitike;
- Reagimi ndaj rreziqeve të vlerësuara të anomalive materiale, duke përfshirë hartimin dhe kryerjen e procedurave të mëtejshme të auditimit për të marrë evidenca të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit; dhe
- Vlerësimi i mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë së evidencave të përfutuara të auditimit, të tilla si përshtatshmëria e supozimeve dhe përfaqësimeve me gojë dhe me shkrim të menaxhmentit

(c) Auditorët ndjekin një proces për të përcaktuar nëse testimi i kontrolleve do ta bëjnë auditimin e përgjithshëm efikas (dmth. do të ndihmojnë në reduktimin e testimit thelbësor dhe rezultatet e testimit të kontrollit do të tregojnë nëse kontrollet janë efektive)

- I. Identifikoni rreziqet dhe objektivat brenda çdo cikli financiar
- II. Konstatimi i Sistemit dhe Kontrolleve të Brendshme
- III. Vlerësimi i sistemeve dhe kontrolleve të brendshme
- IV. Testoni Sistemet dhe Kontrollet e Brendshme (vetëm nëse ato konsiderohen të jenë efektive)

(d) Faza e parë – Identifikoni rreziqet dhe objektivat brenda çdo cikli financiar

- Ne duhet të identifikojmë objektivat (Pohimet e Pasqyrave Financiare) në mënyrë që të dimë se çfarë dëshirojmë që kontrollet të parandalojnë, zbulojnë dhe korrigjojnë.

Faza e dytë – Konstatimi i Sistemit dhe Kontrolleve të Brendshme

- Identifikoni aktivitetet kryesore të biznesit
- Përcaktoni rrjedhën e dokumenteve
- Identifikoni shtrirjen e kontrolleve në lidhje me secilin rrezik dhe objektiv/pohim të pasqyrës financiare
- Kryeni një testim hap-pas-api për të vërtetuar të kuptuarit tuaj

Faza e tretë – Vlerësoni sistemet dhe kontrollet e brendshme

- Nëse auditori teston kontrollet dhe rezultatet vërtetojnë se kontrollet e kompanisë janë efektive, kjo do t'i lejojë auditorit të reduktojë testimin e tij thelbësor.
- dmth nëse kontrollet lidhur me pohimin e plotësisë së shitjeve rezultojnë të jenë efektive, atëherë testimi thelbësor i lidhur me pohimin e plotësisë së shifrës së të hyrave dhe saldos së të arkëtueshmeve do të reduktohet.
- Nëse auditori megjithatë bën një vlerësim të pasaktë dhe mendon se:

- Kontrollat joefektive-efektive ose anasjelltas - kjo do të ndikojë në efikasitetin e auditimit të tij.
- Në vendosjen nëse do të testohen apo jo kontrollat, auditori do të marrë gjithashtu në konsideratë se sa teste thelbësore mund të reduktohet nga një vlerësim efektiv kontrolli

Faza e katërt - Testoni sistemet dhe kontrollat e brendshme (vetëm nëse ato konsiderohen të jenë efektive)

Testet e kontrolleve janë:

- Merret vetëm me ato fusha që i nënshtrohen kontrolleve efektive
- Merret vetëm me ato kontrolle që zvogëlojnë rreziqet dhe mbështesin objektivat
- Mostra përfaqësuese e transaksioneve
- Ka të ngjarë të mbulojë një numër më të madh zërash sesa një test hap-pas-hapi

Detyra 5

Ju sapo keni përfunduar praktikën tuaj në një firmë kontabiliteti dhe auditimi dhe po konkurroni për t'u mbajtur si një anëtar i përhershëm i stafit. Partneri i auditimit i firmës përgjegjës për rekrutimin dëshiron të sigurojë që kandidati i suksesshëm të jetë kompetent në fushat kryesore të procesit të auditimit. Si pjesë e procesit të përzgjedhjes, të gjithë kandidatëve u është kërkuar që t'i dorëzojnë një memorandum partnerit të auditimit në lidhje me sa vijon:

- Letrat e angazhimit të auditimit
- Metodatat e marrjes së dëshmive të auditimit
- Hartimi dhe kryerja e procedurave analitike thelbësore.

Kërkohej:

Përgatitni një memorandum për partnerin e auditimit i cili:

- Përkrahni elementet që duhet të përfshihen në një letër angazhimi auditimi. (7 pikë)
- Përkrahni gjashtë metoda për marrjen e dëshmive të auditimit dhe jep një shembull të shkurtër ilustrues për secilën. (7 pikë)
- Diskutoni faktorët që auditori duhet të marrë parasysh kur harton dhe kryen procedura analitike thelbësore. (6 pikë)

[Gjithsej: 20 pikë]

Zgjidhja

(a) Elementet tipikë të përfshirë në një letër angazhimi auditimi:

SNA 210 Kushtet e Angazhimeve të Auditimit.

- Objektivi i auditimit të pasqyrave financiare.
- Përgjegjësia e menaxhmentit për pasqyrat financiare.
- Fushëveprimi i auditimit, duke përfshirë referencën në legjislacionin në fuqi, rregulloret ose deklaratat e organeve profesionale, të cilave auditori i përmbahet.
- Forma e çdo raporti apo komunikimi tjetër i rezultateve të angazhimit.
- Fakti që për shkak të natyrës testuese dhe kufizimeve të tjera të vetëvetishme të një auditimi, së bashku me kufizimet e vetëvetishme të kontrollit të brendshëm, ekziston një rrezik i pashmangshëm që edhe disa anomali materiale të mbeten të pazbuluara.
- Qasje e pakufizuar në çfarëdo regjistri, dokumentacioni dhe informacioni tjetër të kërkuar në lidhje me auditimin.

(b) Metodatat e përfshirë të dëshmive të auditimit që mund të përdoren nga auditori:

- Inspektimi - Inspektimi fizikisht asetet fikse ose teste të tjera të vlefshme.
- Vëzhgimi - vëzhgimi numërimin e stokeve fizike. Evidenca e auditimit e marrë drejtpërdrejt nga auditori është më e besueshme se evidenca e auditimit e marrë në mënyrë indirekte ose me konkluzion.
- Intervistim (Biseda me menaxhmentin) - Intervistimi i menaxhimit të diferencës së shënuar gjatë numërimit testues të stokeve.
- Konfirmimi - Konfirmimi i llogarive të arkëtueshme/Banka. Evidenca e auditimit është më e besueshme kur merret nga burime të pavarura jashtë entitetit.
- Rillogaritje - rillogaritni normën zhvlerësimit/kamatës.
- Rirkyerja - testimi i sistemeve për kryerjes së procedurave nga auditorit - rakordimi bankar/furnitorëve, etj.
- Procedurat analitike - shpjegimi i lëvizjes së gjendjes së llogarisë nga viti në vit.
- Dëshmia me shkrim është më e besueshme për auditorin sesa dëshmia gojore.
- Dokumentet origjinale janë më të besueshme si dëshmi për auditorin sesa fotokopjet.

(c) Faktorët që duhen marrë parasysh gjatë hartimit dhe kryerjes së procedurave analitike thelbësore:

- Besueshmëria e të dhënave të disponueshme.
- Nëse pritshmëria është mjaft e saktë për të identifikuar një anomali materiale në nivelin e dëshiruar të sigurisë.
- Shuma e çdo ndryshimi të shumave të regjistruara nga vlerat e pritura që është e pranueshme.
- Burimi i informacionit në dispozicion. Për shembull, informacioni është zakonisht më i besueshëm kur merret nga burime të pavarura jashtë entitetit.
- Krahasueshmëria e informacionit në dispozicion. Për shembull, të dhënat e industrisë së gjerë mund të kenë nevojë të plotësohen për të qenë të krahasueshme me ato të entiteti që prodhon dhe shet produkte të specializuara.
- Natyra dhe rëndësia e informacionit në dispozicion. Për shembull, nëse buxhetet janë krijuar si rezultate që priten dhe jo si synime për t'u arritur.
- Kontrollat mbi përgatitjen e informacionit. Për shembull, kontrollat mbi përgatitjen, rishikimin dhe mirëmbajtjen e buxheteve.
- Njohuri dhe të kuptuar të vitit të kaluar.
- Nëse informacioni gjenerohet nga brenda. Për shembull, nëse informacioni gjenerohet nga brenda kompanisë, besueshmëria e tij rritet nëse ai gjenerohet në mënyrë të pavarur nga sistemi i kontabilitetit ose nëse ka kontrolle adekuate mbi përgatitjen e tij.